



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 27/148
Datë: 29.06.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke u bazuar në Strategjinë Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028 dhe Planin e Veprimit 2023-2025, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të ruajtjes së sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale, rendit kushtetues, stabilitetit si dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, "Mbrojtja Civile" apo e njohur si "Civilna zaštita" dhe "Brigada e Veriut" apo e njohur si "Severna brigada", shpallen grupe dhe/apo entitete terroriste në territorin e Republikës së Kosovës dhe vendosen në listën vendore të personave, grupeve dhe entiteteve të përfshira në akte terroriste.
2. Bazuar në informatat, analizat, vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve të sigurisë, grupet dhe/apo entitetet e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi përbëjnë rrezik dhe kërcënim për sigurinë, rendin kushtetues si dhe paraqesin kërcënim terrorist apo kërcënim për kryerjen e veprave terroriste në territorin e Republikës së Kosovës.
3. Obligohen institucionet relevante të rendit dhe sigurisë dhe institucionet e tjera që në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe praktikat ndërkombëtare të ndërmarrin veprimet dhe masat e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/153
Datë: 26.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2023, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014 (17.03.2014), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2023/755 (13.04.2023), Nr. 2023/1215 (23.06.2023), Nr. 2023/1216 (23.06.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP (17.03.2014), amandamentuar me vendimet: (CFSP) 2023/756 (13.04.2023), (CFSP) 2023/1218 (23.06.2023);
 - 1.2. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014) lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve destabilizuese të Rusisë lidhur me situatën në Ukrainë, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2023/1214 (23.06.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP (31.07.2014), amandamentuar me vendimet: (CFSP) 2023/1217 (23.06.2023).
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1, konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, plotësohen apo ndryshohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë